



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 1 NËNTOR 2018, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI**

*(Opozita nuk është e pranishme në këtë seance plenare.)
(Seanca filloi në orën 10:00)*

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 25.10.2018 *(neni 44 i Rregullores)*

2. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*

3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi) për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në Liqenin e Shkodrës” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Sigurinë Kombëtare.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

4. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Bashkimit Europian për bashkëpunimin e zbatimit të ligjit, për vendosjen e oficerit ndërlidhës të Europol-it” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Sigurinë Kombëtare.

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 1 NËNTOR 2018

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

5. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi - Shqipëri, alokimet e vitit 2016” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Integrimin European.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Sigurinë Kombëtare.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

6. Projektvendimi “Për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve” *(neni 111 i Rregullores, votim i fshehtë me shumicë të thjeshtë)*

Raporti i Komisionit përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

7. Njoftimi/miratimi i kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 5 – 23 nëntor 2018 *(neni 27, pikat 3, 4, i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

8. Të bartura për votim:

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” *(neni 81/2 i Kushtetutës dhe nenet*

73-77 të Rregullores, votim me shumicë prej 3/5-ve të të gjithë anëtarëve të Kuvendit)

- Projektligji “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” *(neni 81/2 i Kushtetutës dhe nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë prej 3/5-ve të të gjithë anëtarëve të Kuvendit)*

9. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës *(neni 45 i Rregullores)*

Koha e diskutimeve deri në 60 minuta

Gramoz Ruçi – Të futet media brenda.

Seancën e ditës së sotme e deklaroj të hapur.

(Pasi lexon rendin e ditës.)

A ka vërejtje për procesverbalin? Nuk ka.

Miratohet.

Në Kuvend janë depozituar nga Këshilli i Ministrave projektbuxheti për vitin 2019 dhe 7 projektligjet e paketës fiskale.

Ju njoftoj se dje është mbledhur Konferenca e Kryetarëve, ku u bë prezantimi i projektbuxhetit nga ministri i Financave, si dhe u diskutua për projektkalendarin e shqyrtimit të buxhetit dhe të projektligjeve që shoqërojnë atë në komisione dhe në seancë plenare. Meqenëse opozita nuk mori pjesë në mbledhjen e Konferencës, projektkalendarin do të votohet së bashku me çështjet e tjera të rendit të ditës.

Gjithashtu, në Kuvend janë depozituar edhe 5 projektligje të tjera nga Këshilli i Ministrave, si dhe 2 nisma deputetësh. Ndërsa nga Presidenti i Republikës është depozituar dekreti për shkarkimin e ministrit të Punëve të Brendshme. Si gjithmonë, materialet do t'i gjeni të publikuara në faqen e Kuvendit në internet.

Njëkohësisht, ju njoftoj se në tavolinat tuaja shërbimet e Kuvendit kanë shpërndarë modelin e deklarimit të gjendjes së konfliktit të interesit nga deputetët. Ky është një detyrim i përcaktuar në Kodin e Sjelljes së Deputetëve, si dhe në udhëzuesin e detajuar për sjelljen në Kuvend.

Këtë model deklarate do ta gjeni edhe në faqen zyrtare të Kuvendit në Internet. Në bazë të nenit 13, pika 3, të Kodit të Sjelljes: “Kur deputeti është në konflikt interesi për çështjet në shqyrtim, plotëson deklaratën me shkrim dhe ia dorëzon Shërbimit të Kuvendit për Trajtimin e Deputetëve”.

Fillojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi) për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në liqenin e Shkodrës”.

Fjalën e ka kërkuar zëvendëskryeministrja, zonja Mesi.

Senida Mesi – I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qeveria jonë ka marrë angazhimin për masa konkrete për të përmirësuar mirëqenien e çdo qytetari kudo dhe çdo ditë. Sfidat e këtij mandati janë dy: së pari, integrimi në Bashkimin Europian dhe të gjitha reformat e ndërmarra në lidhje me këtë proces; së dyti, punësimi, që është kryeprioriteti i qeverisë. Nëse i shikojmë të dyja prioritetet të lidhura me njëri-tjetrin dhe se çfarë është dakordësuar edhe si rezultat i Procesit të Berlinit, do të shohim se kemi një rritje të bashkëpunimit midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, sidomos në fushën e sigurisë, rritje të stabilitetit në rajon dhe të konektivitetit, duke synuar rritjen e lëvizjes së mallrave, të shërbimeve dhe, çfarë është më e rëndësishme, rritje të komunikimit midis njerëzve.

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi) për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në liqenin e Shkodrës” është në linjë me përpjekjet intensive për të rritur pikërisht shkëmbimet midis dy vendeve fqinje dhe për ta transformuar pikën e Zogajt në një nga lagjet e mrekullueshme të qytetit të Shkodrës, si dhe liqenin e Shkodrës, një liqen që na bashkon, në një atraksion turistik dhe në një qendër të zhvillimit ekonomik rajonal.

Për këtë pikë kufitare është dakordësuar në mbledhjen e dy qeverive, e cila u mbajt në

Shkodër në korrik të këtij viti, duke u dhënë të dyja vendeve tona një mundësi të artë për të përmirësuar komunikimin e mëtejshëm, bashkëpunimin fitimprurës midis dy vendeve, sigurisht për të rritur dhe për të krijuar kushte optimale për zhvillimin e këtij bashkëpunimi për lehtësimin e qarkullimit në kufirin e përbashkët shtetëror.

Pika e përbashkët e kalimit kufitar do të ndërtohet në territorin e Shqipërisë, në fshatin Zogaj, dhe do të ketë një rikonstruksion të rrugës, që fillon në Malin e Zi, Shirokë dhe Shkodër. Pika e përbashkët e kalimit kufitar do të jetë e hapur 24 orë. Cili është qëllimi?! Lehtësimi i qarkullimit në pikën e përbashkët duke lehtësuar komunikimin, lëvizjen e lirë të shtetasve dhe mjeteve në zonat afër Bashkisë Shkodër dhe Malësisë së Madhe dhe zonave të malësisë së Krajës, komunës së Tivarit, Barit dhe Virpazarit në Malin e Zi. Kjo pikë e re mundëson jo vetëm shkurtimin e distancave për banorët e Shkodrës dhe Malësisë së Madhe, por edhe më gjerë. Ajo siguron një kontroll më të mirë të bregut të liqenit të Shkodrës dhe një shfrytëzim të vlerave turistike të liqenit dhe të traditave të banorëve të Malësisë së Tivarit. Kjo pikë e përbashkët do të ndikojë edhe në lehtësimin e fluksit në sezonin turistik në pikën e përbashkët të kalimit kufitar në Muriqan.

Ky projekt vjen dhe propozohet në linjë edhe me konceptin e 100 fshatrave. Fshati Zogaj është pjesë e këtij koncepti, pasi është i njohur jo vetëm për atraksionin turistik, jo vetëm për vlerat kurative të bimëve medicinale, por sigurisht edhe për artin e peshkimit. Si rezultat i kësaj, ne mendojmë se një investim i tillë dhe një pikë doganore e tillë do t’i japin edhe fshatit Zogaj një vlerë të shtuar.

Në fakt, nuk është hera e parë në historinë e Shkodrës, sidomos të Virpazarit, ku këto dy shtete kanë komunikuar në vijë rrugore dhe ujore me njëri-tjetrin. Historiku fillon që në shekullin e IV Para Erës së Re me fisin zejtar të lundëtarëve labeatë dhe monopolin. Si qendra më e rëndësishme jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Ballkan, Shkodra do ta ruante deri në shekullin e XIX, ku pazari i vjetër i Shkodrës deri në vitin 1930 numëronte mbi 3500 dyqane dhe afër urës së Bunës ishte pika doganore, duke e bërë liqenin e Shkodrës, nga njëra anë, dhe Shkodrën, nga

ana tjetër, hipermarketin më të madh të asaj kohe.

Sot po i kthejmë mundësinë Shkodrës të ketë një sukses të tillë në histori, për t'u bërë përsëri faktor i zhvillimit të biznesit, tregtisë apo zejtarisë, duke filluar pikërisht me mundësinë që të jep një pikë e tillë doganore. Projektet, të cilat janë të ndërlidhura ngushtë me njëra-tjetrën, do të lehtësojnë këtë zhvillim ekonomik, duke filluar me Velipojën, si qytet turistik bregdetar: rruga e Velipojës, Harku i Bërdicës - fshati Baks, që është në përfundim, projekti i rrugës së Velipojës që do të lidhet me Shëngjinin, i cili po studiohet dhe do të kapë vlerën rreth 10 milionë euro; ndërlidhja kufitare Velipojë-Kulaj-Ulqin, që me rrugën e re do të bëhet për 20 minuta; përmirësimi i lumit Buna, i cili do të bëhet me fondet e bashkëpunimit ndërkufitar IPA, me vlerë rreth 5 milionë euro, sistemimi i bregut perëndimor të liqenit, një punë kjo e filluar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit me fondet e Bashkimit European dhe BERZH-it, që kap vlerën e investimit rreth 8 milionë euro dhe kjo që po diskutojmë sot, lidhja ndërkufitare Zogaj-Mali i Zi, që nëpërmjet fondeve ndërkufitare IPA do të kapë një vlerë investimi prej 6 milionë eurosh. Janë pikërisht këto investime, sidomos atë të fokusuara në zonën e liqenit, të cilat synojnë shndërrimin e zonës së Shirokës dhe bregut perëndimor të liqenit Shkodër me një atraksion dhe destinacion të mirëfilltë turistik, që ofrojnë hapësira urbane dhe natyrore të dedikuara për të gjithë të apasionuarit e natyrës, historisë dhe sportit.

Koncepti i përgjithshëm i zhvillimit të zonës së Shirokës ndërthur hapësirat urbane dhe ato natyrore me identitetin dhe traditat e atij vendi. I gjithë koncepti ka synim të ruajë identitetin e zonës, zhvillimin urban dhe natyror, duke bërë që krahas rehabilitimit të sheshit, i cili do të restaurohet në konceptin tradicional, sikurse është rasti i mozaikëve të sheshit, që do të jenë të ngjashëm me qilimat e përpunimit të asaj zone, të restaurohen edhe fasadat e ndërtesave të zonës nëpërmjet materialeve dhe ngjyrave pak a shumë të njëjta.

Tashmë ne kemi gati të nënshkruar edhe marrëveshjen për marrëdhëniet e ndërsjella midis dy shteteve, përsëri Mali i Zi dhe Shqipëri, në lidhje me burimet natyrore dhe ujore të përbashkëta. Kjo marrëveshje na lejon punime të

përbashkëta edhe në rehabilitimin apo thellimin e lumit Buna në bashkëpunim reciprok edhe me liqenin e Shkodrës.

Më lejoni t'ju bëj me dije se në vijim të kësaj, edhe buxheti i ri, të cilin ne do ta kalojmë së shpejti në Kuvend, ka një numër të madh politikash, të cilat do të nxisin bizneset e reja, zejtarinë, tregtinë dhe ndërmarrjet sociale, që së bashku me politikat tona, investimet në infrastrukturë dhe ndërlidhjet do të kenë sinergjinë e duhur për t'i dhënë biznesit dhe klimës së biznesit frymën e duhur.

Politikat ekonomike, politikat fiskale dhe çdo politikë tjetër që po ndërmarrim janë politika të cilat krijojnë një klimë të duhur ekonomike për hapjen e bizneseve të reja. Vetëm kështu ne mund të sigurojmë një rritje ekonomike të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Vetëm kështu ne mund të sigurojmë një rritje të mirëqenies së popullatës.

Ne po punojmë me përgjegjshmëri dhe me vëmendje maksimale të njerëzit, ndaj edhe politika jonë është politika e debatit konstruktiv, e punës dhe e vendimeve të mira, që mund të marrim për zhvillimin e vendit tonë. Po punojmë çdo ditë që të jemi më pranë Bashkimit European dhe këto nisma konkrete janë në favor të qëllimit të përbashkët, jashtë retorikave boshe, jashtë filmave serialë apo videopërgjimeve. Ne jemi pro rritjes ekonomike, pro politikave sociale, luftës pa kompromis ndaj krimit të organizuar e korrupsionit dhe pro rritjes dhe mirëqenies së popullatës. Ne përmirësojmë çdo ditë dhe me hapa konkretë jetën e çdo shqiptari. Kjo është politika jonë, por politika e opozitës cila është?!

Ju faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Mesi!

Fjalën e ka kërkuar ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, zoti Bushati.

Ditmir Bushati – Zoti Kryetar,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Këshilli i Ministrave sjell në Kuvend për miratim një marrëveshje të rëndësishme për pikën e kalimit kufitar Zogaj-Skje, e cila u miratua më 3 korrik ndërmjet dy qeverive tona, asaj të Shqipërisë dhe Malit të Zi.

Kjo është e para qeveri, e cila vendosi praktikën e mbledhjeve të përbashkëta me të gjithë fqinjët, duke filluar me Kosovën në vitin 2014, për të vazhduar me Maqedoninë dhe Malin e Zi, ku diskutohen të gjitha axhendat e

ndërlidhjes ekonomike, infrastrukture dhe mbi të gjitha njerëzore të rajonit tonë.

Kur flasim për hapjen e kësaj pike kufitare është e rëndësishme të kemi parasysh jo vetëm lehtësimin e qarkullimit të njerëzve, por mbi të gjitha ndërlidhjen e trevave shqipfolëse, sepse, siç u tha këtu edhe nga zëvendëskryeministrja, flasim për një ndërlidhje midis Shirokës, Zogajt dhe Malësisë së Krajës apo pjesës së Tivarit, ku përgjithësisht jetojnë shqiptarë dhe është një zonë, e cila ka ende mundësi për t'u shfrytëzuar pozitivisht për turizëm, por, mbi të gjitha, edhe në kuadër të bashkëpunimit që agjenci të ndryshme turistike kanë ndërmjet dy anëve të kufirit për të shfrytëzuar paketa dhe oferta turistike të përbashkëta për turistët që dëshirojnë të vizitojnë këtë pjesë të Europës. Në këtë kontekst, e gjithë pjesa e liqenit të Shkodrës do të mbulohet dhe do të krijohet një akses shumë i madh jo vetëm për banorët e zonave përkatëse, por edhe për ata turistë që dëshirojnë të vizitojnë Shqipërinë dhe Malin e Zi.

Elementi i dytë dhe më i rëndësishëm, përtej asaj që ne kemi rënë dakord me Malin e Zi, ka të bëjë me zhvillimin e zonës. Ne kemi rënë dakord, në kuadër të programit tripalësh Shqipëri-Mal i Zi-Itali, që mbështetet nga fondet e Bashkimit European, për një projekt rreth 7 milionë euro, i cili do të ketë dy objektiva specifike: e para, vendosjen e një linje transporti multimodal ndërmjet portit të Barit, portit të Shëngjinit dhe portit të Barit në Malin e Zi, sepse bëhet fjalë për hapësirën e Adriatikut, dhe ndërlidhjen me liqenin e Shkodrës dhe me lumin e Bunës; së dyti, vendosjen e një linje transporti liqenor nëpërmjet molit të Virpazarit në Malin e Zi me molin e Zogajt, Shirokës për të krijuar një mundësi që liqeni të jetë më i rivitalizuar sesa është sot.

Ky projekt do të fokusohet fillimisht vetëm tek transporti i udhëtarëve për t'u krijuar mundësi qytetarëve për të lëvizur më shpejt dhe në mënyrë më komode. Nga ana tjetër, do t'u krijojnë mundësi vizitorëve të huaj për të pasur turizëm ditor qoftë në Mali të Zi apo në Shkodër te pjesa e liqenit dhe, në perspektivë, në fazën e dytë dhe të tretë, ky projekt do të shkojë edhe në pjesë që kanë lidhje me Shëngjinin, Velipojën dhe lumin e Bunës.

Gjëja e fundit që dua të them në këtë drejtim ka të bëjë me angazhimin tonë të plotë

për një dimension më të fortë ndërrajonal, ndërkufitar jo vetëm me Malin e Zi dhe me këtë pikë të kalimit kufitar, por siç do të diskutojmë edhe te marrëveshja IPA-s me Malin e Zi, të cilën ne do të miratojmë, shpresoj, sot në Kuvend, ka disa projekte të rëndësishme, të cilat janë në funksion të ndërlidhjes së qytetarëve, të zhvillimit të infrastrukturës ndërmjet vendeve tona, të cilat flasin qartë për një qasje progresive të qeverisë sonë dhe për politikë, të cilat kanë në qendër të vëmendjes qytetarët.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Ministër!

Kalojmë në diskutimet në emër të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të PS-së, fjalën e ka zoti Luan Harusha.

(Zoti Harusha tërhiqet nga diskutimi.)

Atëherë, kalojmë te projektligji tjetër "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Bashkimit European për bashkëpunimin e zbatimit të ligjit mbi vendosjen e oficerit ndërlidhës të Europol-it".

Janë regjistruar për diskutim deputetët: Pjerin Ndreu dhe Alket Hyseni.

Zoti Hyseni, keni fjalën.

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Sot po sjellim për miratimin një projektligj, i cili ka në thelb ratifikimin e marrëveshjes së Republikës së Shqipërisë me Agjencinë e Bashkimit European për Bashkëpunim e Zbatim të ligjit. Ky është një institucion mjaft i rëndësishëm, me të cilin Republika e Shqipërisë ka një bashkëpunim të hershëm jo thjesht në kohë, por edhe në cilësi e vlerë.

Marrëveshja është iniciuar nga Europol-i dhe buron nga një marrëveshje e mëparshme, e nënshkruar që në vitin 2013 midis Republikës së Shqipërisë dhe këtij institucioni, dhe e ratifikuar në vitin 2014.

Në thelb të kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe çdo forme tjetër të krimit ndërkombëtar.

Format e bashkëpunimit konsistojnë në disa drejtime. Shkurtimisht unë do të ndalem në shkëmbimin e informacionit, të specialistëve të fushave të ndryshme të policimit, të raporteve

dhe të analizave strategjike midis Republikës së Shqipërisë dhe Europol-it në dhënien e informacionit për procedime hetimore penale, kryesisht në fazat paraprake, në trajnime, konsulenca etj. Nga ana teknike, marrëveshja konsiston në vendosjen e oficerit ndërlidhës të Europol-it në Republikën e Shqipërisë, i cili do të ketë jo më pak status sesa kanë përfaqësuesit diplomatikë të shteteve me të cilat Republika e Shqipërisë ka marrëveshje, në mënyrë që t'i ofrojë këtij oficeri operativitet në kushte të lira dhe bashkëpunim maksimal me policinë shqiptare.

Në fakt, kjo marrëveshje nuk ka rëndësi thjesht teknike, por ka rëndësi të madhe politike, sepse mbështet Ministrinë e Brendshme dhe Policinë e Shtetit në luftën kundër krimit të organizuar, i cili i ka shtrirë tentakulat tashmë në shumë vende, kundër krimit ndërnacional, i cili ka treguar se nuk pyet për racë, ngjyrë, por vetëm për përfitimet kriminale të grupeve që ndërveprojnë. Për t'iu përgjigjur këtyre sfidave kërkohet bashkëpunim ndërinstitucional, i cili me mbështetjen politike që ne i japim nëpërmjet marrëveshjeve të caktuara, por jo vetëm, Policisë së Shtetit, e bëjmë policinë më efikase.

Ne jemi krenarë të paraqesim përpara publikut rezultatet konkrete që ka pasur Policia e Shtetit kohët e fundit, sidomos në kuadër të këtyre bashkëpunimeve. Publiku është dëshmitar, kur jo më larg se pak më parë, falë bashkëpunimit me agjencitë partnere të vendeve të ndryshme dhe me Europol-in, janë goditur grupe kriminale të mirorganizuara në përbërje të të cilave ka pasur shtetas shqiptarë, shtetas të vendeve të BE-së apo shtetas me kombësi të tjera.

Format e organizimit kanë qenë mjaft të sofistikuar, me teknologji dhe me financime të avancuara, gjë që tregon se në të njëjtat përmasa, ndoshta edhe më mirë, duhet të jetë e mbështetur edhe Policia e Shtetit.

Ndërkohë që Policia e Shtetit dhe Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë është në ballë të luftës kundër krimit, ka faktorë të caktuar politikë, e them me keqardhje, që mungojnë sot në këtë sallë, të cilët nuk dinë dhe nuk gjejnë kurajën për ta mbështetur Policinë e Shtetit me mbështetjen që meriton në luftën kundër krimit.

Policia e Shtetit nuk është një vegël e pushtetit të radhës, por është mekanizmi i shtetit

për të ruajtur rendin dhe sigurinë publike, sigurinë e fëmijëve, atë të qeveritarëve dhe të opozitarëve të atij momenti, të socialistëve në pushtet apo në opozitë, të demokratëve në pushtet apo në opozitë dhe jo vetëm të tyre, por të të gjithë shtetasve të Republikës së Shqipërisë. Për këtë arsye ajo meriton që ne ta mbështesim fuqimisht pa asnjë ekuivok, ta mbështesim politikisht nëpërmjet votës, kur është e nevojshme për marrëveshje të tilla, por edhe nëpërmjet deklaratave politike sa herë që ajo përballlet me krimin.

Me keqardhje konstatojmë se ditët e fundit ka pasur një aksion të ulët politik të opozitës kundër forcave elitare të Republikës së Shqipërisë në krye të misionit dhe të detyrës së tyre. Të etiketosh dhe të vësh në dyshim aktivitetin e policisë, sidomos të forcave elitare, nuk është thjesht një mospërkrahje politike, por është shumë më tepër, është një akt djallëzor i opozitës së sotme për të shkakuar edhe dëmtim të marrëdhënieve të Republikës së Shqipërisë me vendet fqinje, edhe dëmtim të raporteve ndëretnike në Shqipëri me minoritetin grek, me të cilin ne kemi marrëdhënie të shkëlqyera, edhe për të dëmtuar punën e Policisë së Shtetit, edhe për të dëmtuar marrëdhëniet e Republikës së Shqipërisë me Greqinë.

Unë i bëj thirrje opozitës të dalë nga bataku ku është katandisur dhe të mos ofendojë ndërgjegjen dhe inteligjencën e popullit shqiptar dhe, për më tepër, të mos bëjë lojëra të ulëta në kurriz të interesave tona kombëtare!

Forcat elitare të RENEA-s bënë detyrën e tyre kur ndërhyjnë kundër një agresori ndaj Policisë së Shtetit, kundër dikujt, pavarësisht se ishte minoritar. Ato do të ndërhyjnë njësoj edhe nëse agresori do të ishte me kombësi shqiptare, shtetas i huaj, apo shtetas i vendeve të BE-së, i cili do të ngrinte armën kundër Policisë së Shtetit dhe do të vinte në rrezik jetën e banorëve të fshatit apo të qytetit, ku mund të ndodhte ngjarja. Në këto kushte, për më shumë kur janë procedura strikte të veprimeve të policisë, të cilat gjithsesi, në çdo rast, hetohen dhe investigohen, deklaratat dashakeqe të opozitës ndikojnë negativisht në të gjitha aspektet.

Ne nuk jemi krenarë kur ka humbje jetësh.

Gjej rastin të ngushëlloj familjen e të vrarit në Bularat, por nga ana tjetër, i bëj thirrje policisë të mbajë të njëjtin standard si përherë

kundër kujtdo, që tenton të vërë dorë mbi interesat e qytetarëve të zakonshëm të këtij vendi, mbi qetësinë dhe punën e përditshme të tyre dhe, për më shumë, të jetë e kujdesshme dhe të reagojë menjëherë kundër kujtdo, i cili, për qëllime të ulëta apo shtysa nacionaliste, kërkon të dëmtojë marrëdhëniet tona të shkëlqyera me minoritetin grek apo me minoritetet e tjera të njohura në Republikën e Shqipërisë.

Prandaj, të nderuar kolegë, unë do të doja që opozita të ishte sot këtu, të gjente kurajën dhe të kërkonte ndjesë edhe kundër këtyre deklaratave që u bënë ndaj policisë dhe të tregonte me anë të votës, pra miratimit të kësaj marrëveshjeje, sepse në thelb edhe opozitarët mbeten qytetarë të këtij vendi dhe kërkojnë që rendi dhe siguria të jenë në nivele optimale.

Natyrisht, ne mund të mos jemi dakord me opozitën në shumë aspekte, por statistikën janë kokëforta dhe tregojnë se rendi dhe siguria publike janë shumë më mirë sot se para 5 vjetëve, kur ne morëm pushtetin dhe, natyrisht, janë shumë herë më mirë se para 10 vjetëve, kur opozita e sotme qeveriste.

Disa thonë: "Lëri statistikën, se ne ndjekim perceptimin!"

Cili është perceptimi? Është perceptimi i thashethemnjave të kafeneve të opozitës apo të portaleve dhe të medieve të nxitura nga opozita, të cilat nga mëngjesi deri në darkë synojnë të injektojnë frymën e mungesës së rendit dhe të siguriës në Shqipëri, apo raportet e organizmave më prestigjioze ndërkombëtare e pse jo, edhe raportet e Policisë së Shtetit, të prokurorisë dhe të gjykatave, të cilat tregojnë katërcipërisht se niveli i kriminalitetit në të gjitha aspektet është shumë më i ulët?

Patjetër, niveli nuk është ai që ne dëshirojmë dhe jemi akoma shumë larg asaj ku synojmë të arrijmë, por ne nuk mund të jemi të verbër apo të mbyllim sytë për të vlerësuar arritjet e mëdha që janë bërë këto vite nga qeveria e Kryeministrit Edi Rama dhe nga Policia e Shtetit.

Prandaj, të nderuar kolegë, ju ftoj ta miratoni njëzëri këtë marrëveshje edhe në mungesë të opozitës!

Ne do të vazhdojmë të bëjmë detyrën tonë, detyrë që e kemi marrë nga vota e popullit.

Ne do të vazhdojmë ta mbështesim qeverinë shqiptare, Policinë e Shtetit dhe të

gjitha institucionet në luftën kundër krimit, veçanërisht kundër krimit të organizuar dhe atij transnacional. Ne jemi këtu pikërisht për këtë mision.

Ata që e kanë ngatërruar misionin dhe e kanë lidhur mandatin që u ka dhënë populli me interesat e ngushta, le të mos vijnë, le të rrinë në oborret e partive të tyre, duke përhapur panik se do të vijnë në pushtet me çdo formë, por ta harrojnë se mund të vijnë në pushtet me metoda dhune. Në pushtet vihet vetëm me votën e popullit dhe populli di t'i etiketojë dhe t'i dënojë ata që nuk mbrojnë interesat e tij dhe di t'i vlerësojë ata që punojnë. Në punë e sipër ata mund të bëjnë edhe gabime, ama, ata dinë të përmirësohen dhe të tregojnë me fakte se çdo ditë bëhet më mirë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Hyseni!

Fjalën e ka zoti Ndreu.

Pjerin Ndreu – I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Europol-i është një institucion mjaft i rëndësishëm i Bashkimit Europian dhe marrëveshja për të vendosur oficerin e kontaktit në Shqipëri është një hap para në bashkëpunimin ndërmjet Policisë së Shtetit të Shqipërisë dhe Europol-it.

Personalisht kam pasur rastin të jem disa herë në Europol gjatë kohës kur kam qenë me detyrë në Policinë e Shtetit, ku kam vënë re gjithmonë dashamirësi dhe seriozitet për të ezauruar disa aspekte të kriminalitetit shqiptar, si dhe për të bashkëpunuar me autoritetet shqiptare në luftën kundër krimit.

Duke qenë se Europol-i është një partner serioz ose një institucion serioz dhe na shtrin dorën e bashkëpunimit, kjo tregon se vlerësimi ndaj Policisë së Shtetit është shumë i lartë. Fatkeqësisht, bashkëpunimi ndërkombëtar ndërmjet institucioneve ndërkombëtare, ku bën pjesë Europol-i, dhe Policisë së Shtetit është shumëfish më i mirë sesa bashkëpunimi ndërmjet faktorëve politikë në luftën kundër kriminalitetit dhe institucioneve ligjzbatuese në këtë luftë, dhe kjo duhet pranuar.

Policia e Shtetit shqiptar ka një rekord, që vlen të përmendet: në 99%, për të mos thënë 100%, të operacioneve ndërkombëtare në luftën kundër krimit të organizuar me partnerët

ndërkombëtarë ka qenë e suksesshme, çka na bën krenarë, sepse janë rezultate të certifikuara që e kanë bërë Policinë e Shtetit çdo ditë e më shumë një partnere të besueshme. Pikërisht, vendosja e oficerit të kontaktit këtu do t'i japë një shtysë shumë më të mirë luftës kundër krimit, se, në fund të fundit, duhet evidentuar ajo që është thelbësore: krimi i organizuar ka natyrë ndërkombëtare.

Përtej interpretimeve skandaloze dhe keqdashëse të niveleve joprofesionale, me qëllim për të helmuar opinionin publik, krimi i organizuar nuk është fenomen shqiptar, as ka lindur në Shqipëri dhe as vdes në Shqipëri. Natyrisht, Shqipëria ka problemet e saj me krimin e organizuar shqiptar. Grupet e krimit të organizuar shqiptar nuk janë grupe elitë në botë. Faktorë të ndryshëm politikë në Shqipëri, të cilët nuk dinë se ku fillon dhe mbaron lufta antikrim, mundohen t'i nxjerrin shqiptarët si të parët. Kjo nuk është e vërtetë.

Karakteri i dhunshëm i shqiptarëve, pas emigrimit në vitet '90 dhe tendenca që ata shfaqën për t'u pasuruar atje, i evidentuan si grupe të rrezikshme, por jo për nga skema e organizimit dhe potencia financiare. Ndërkohë ne, me retorikën tonë të pashembullt, në agresion të hapur kundër vendit tonë, kemi prodhuar dhe vazhdojmë të prodhojmë një histori të paqenë, duke e vendosur krimin e organizuar shqiptar në majën e grupeve të krimeve të organizuara në botë.

Politika jonë bën shërbimin më të keq, më të pavërtetë, bën shpifjen më monstruoze kundër vendit të saj, duke e mbuluar me bojë të zezë, kur ne, në fakt, nuk jemi në këto pozita që thuhet.

Kriminalitet do të ketë. Nëse dikush në Shqipëri, i çfarëdolloj niveli shoqëror të jetë, beson se një ditë Shqipëria do të ketë zero kriminalitet, kjo është e pamundur dhe nuk mund të ndodhë jo këtu, por as në një vend të zhvilluar të botës.

Është e çuditshme se si politika e djathtë ka një reagim për çdo krim; për çdo krim që ndodh, ka një fajtor. E kush është fajtori?! Qeveria. Kjo është sjellje e padenjë, madje e turpshme me trajtimet e luftës antikrim.

Nga faktorët e opozitës nuk jepet as edhe një kontribut në përmirësimin e klimës së kriminalitetit, nga opozitarët tanë, çka e bën

opozitën një ndër grupet më të çuditshme politike në botë. Nuk ndodh askund në botë që për një krim, sado i rëndë, të jetë shkak për t'iu sulur kundërshtarëve politikë, duke thënë njëmijë e një gjëra të paqena. Pra, krimi ekziston dhe do të ekzistojë.

Krimi matet me statistika, jo me fjalë. Por ka një tendencë për ta futur në disa hulli të pashpjegueshme, saqë edhe shpjegimet publike janë anemike. Mirë, mor ti, që flet për kriminalitet, më thuaj sa është rritur dhe sa është ulur kriminaliteti? Statistikat zyrtare janë ato që na tregojnë se si rritet kriminaliteti; janë matjet e kriminalitetit. Këto statistika zyrtare, e kam thënë edhe më parë, do ta them dhe do ta stërthem, madje do të duhet t'i rrimë kësaj, i nxjerrin policia, prokuroria dhe gjykata. Këto janë tre institucionet shtetërore që hartojnë statistika. Mund t'i bëjnë statistikat edhe mediet, edhe organizatat e ndryshme joqeveritare, por duhet të tregojnë metodologjinë si e kanë matur kriminalitetin.

Në statistikat e kriminalitetit ne kurrsesi nuk jemi me ngjitje, jemi me ulje.

Si mund të thuash se e ke futur një vend në kaos, kur ti e ke ulur 60% krimin e vrasjes, dhe për çdo vrasje duhet të reagosh dhe të fajësosh qeverinë pse ndodhi një vrasje?! Vrasje do të ketë përsëri.

Le të dalë një person nga opozita që është aq i zoti sa ta ul nivelin e vrasjeve në zero dhe unë jam dakord që ta bëjmë ministër të Brendshëm të përjetshëm ose Kryeministër të përjetshëm. Na thoni një. Nuk ka shans të ndodhë. As në vendet më të zhvilluara të botës nuk ndodh. Nuk ka asnjë vend që nuk ka banda apo trafik droge. Diskutimi është sa janë strukturat e shtetit të angazhuara në luftën kundër këtyre fenomeneve. Si shpjegohet që sa herë ne arrijmë rezultate të rëndësishme në luftën kundër krimit zgjohet edhe kori i papërgjegjshëm i opozitës për të goditur këto rezultate? Nuk i intereson qetësia publike? Nuk i intereson lufta kundër krimit? Nuk i intereson që ne të jemi një vend shumë më i qetë? Si ka mundësi që të gjithë partnerët ndërkombëtarë na vlerësojnë, kurse shqiptarët, ata që i kemi vëllezër të një gjaku, pavarësisht se mbrojmë siglat e partive të ndryshme, jo vetëm që nuk na vlerësojnë, por gjejnë një mijë e një arsye për të thënë disa gjëra që vetëm ata i dinë dhe i shpikin. Disa juristë

dhe njohës të kriminalitetit kanë degraduar në argumente alla Berisha. Nuk dinë çfarë kanë lexuar dhe çfarë thonë. Dalin dhe thonë gjëra të çuditshme. Gjithsesi, ky është problemi i tyre.

Sa më shumë të nënshkruajmë marrëveshje të tilla, aq më shumë ne i afrohem Bashkimit Europian, sa më shumë policia shqiptare të jetë partner i besueshëm, aq më shumë ne e kemi të sigurt rrugën tonë dhe lufta kundër krimit ka shpresë dhe është në shinat e duhura.

A ka probleme? Po, ka akoma probleme të pazgjidhura, por unë mendoj se nga gabimet duhet të nxjerrim edhe mësim, sepse në luftë kundër krimit bëhen edhe gabime. Unë kërkoj publikisht që t'i krijohej njëfarë frymëmarrje më e dukshme nivelit profesional dhe teknik të Policisë së Shtetit. Oficerët e policisë duhet të marrin në dorë situatën dhe të tregojnë rrugët se si do të realizohen objektivat. Qeveria duhet të krijojë të gjitha kushtet e nevojshme që Policia e Shtetit jo vetëm të drejtojë luftën kundër krimit, por të ketë edhe mbështetjen e duhur me të gjitha mjetet logjistike, speciale, zbuluese dhe të gjitha trajnimet që i duhen.

Nga ana tjetër, duhet patjetër reforma në drejtësi, e cila fillon me vetingun e shumëkërkuar, por që lidhet edhe me vetingun në Policinë e Shtetit, sepse policia është institucion në zinxhirin e organeve ligjzbatuese dhe atë të drejtësisë penale. Pa konfigurimin e të gjitha këtyre institucioneve lufta kundër krimit do të jetë fragmentare dhe e paqartë ose nuk do të realizojë ato kërkesa që ka opinionin publik. Unë mendoj se jemi në rrugën e duhur, por duhet ecur më shpejt, sepse mundësitë janë.

Dua të përmend pak një agresion të pashembullt që Berisha me gjithë suitën e tij ka ndërmarrë ndaj meje personalisht dhe familjes sime. Nuk do të jap komente për të treguar se kush është ai dhe kush jam unë, sepse shqiptarët e dinë kush është ai, por dua t'i them publikisht Saliut dhe suitës së tij, ia rikonfirmoj edhe një herë, se deri në pesë breza, as nga nëna dhe as nga babai, nuk kam asnjë njeri të evidentuar, ndaluar apo shoqëruar për trafik. Nëse më gjen një të afërm deri në pesë breza, i bëj sfidë ta thotë publikisht dhe unë do të largohem nga politika. Jam krenar që jam pjesë e një prej familjeve më të mira të këtij vendi dhe ndiej neveri për të gjithë baltosjen që më bën jo vetëm mua, por gjithkujt që e ka kundërshtar në

politikë. Atij njeriu i ka humbur vula. Ai është një matuf, të cilin ne nuk duhet ta marrim në konsideratë. Premtoj para jush se nuk do të merrem më me të, sepse është humbje kohe. Lehja është pa lekë, është e lirë, dhe ne do t'i lemë të lehin, kurse vetë do të vazhdojmë të mbështesim marrëveshje të tilla për luftën kundër krimit, që kanë të bëjnë me bashkëpunimin serioz me institucione serioze siç është EUROPOL. Unë kam besim se kolegët e mi, ashtu siç kanë vepruar gjithmonë, do të votojnë të gjithë pro kësaj marrëveshjeje.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Ndreu!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste fjalën e ka zoti Qefaliaj.

Xhemal Qefaliaj – Faleminderit, zoti Kryetar!

Për të disatën herë, ashtu si edhe kolegët e mi, edhe unë shpreh keqardhje që përfaqësuesit e opozitës nuk janë prezentë, aq më tepër kur kemi të bëjmë me marrëveshje të tilla, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë kombëtare.

Mund të kemi, dhe natyrisht që ka ndasi për sa i përket programit për ekonominë, bujqësinë, arsimin, por kur diskutohen çështje që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me sigurinë kombëtare, është edhe në interesin e opozitës që t'i mbështesë dhe të japë opinionin e saj që siguria dhe rendi të jenë në standardet bashkëkohore.

Në këtë kontekst, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste paraqesim sot një tjetër projektligj që ka të bëjë me ratifikimin e një marrëveshjeje midis Republikës së Shqipërisë dhe agjencisë së Bashkimit Europian, për vendosjen e një oficeri ndërlidhës të EUROPOL-it.

Qëllimi dhe objektivat e projektligjit kanë të bëjnë drejtpërdrejt me forcimin e marrëveshjes së nënshkruar nga Republika e Shqipërisë dhe zyrës së EUROPOL-it për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, i nënshkruar në vitin 2013 në Hagë.

Kjo marrëveshje synon vendosjen e oficerit ndërlidhës, në bashkëpunim të ngushtë me Bashkimin Europian dhe EUROPOL-in në veçanti, i cili do të asistojë në vendin tonë dhe do të ketë një akses të shpejtë, të lehtë teknikisht, për të komunikuar dhe për të raportuar me vendet e tjera partnere lidhur me problematika

dhe individë të ndryshëm, të cilët kanë rekorde kriminale.

Vendosja e këtij oficerit ndërlidhës të EUROPOL-it në vendin tonë, konkretisht në Zyrën Kombëtare të EUROPOL-it pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, synon të sjellë një mbështetje reale, një bashkëveprim dhe një bashkëpunim për të parandaluar luftën kundër krimit të organizuar, kundër terrorizmit dhe formave të tjera të shfaqjes së krimit në arenën ndërkombëtare, si dhe për të lehtësuar bashkëpunimin e informacionit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, EUROPOL-it dhe shteteve të tjera të Bashkimit Europian.

Njëkohësisht, në marrëveshje është parashikuar që oficeri i ndërlidhjes duhet të respektojë doemos rregullat e shtetit shqiptar në masën që është e zbatueshme, në lidhje me praninë e tij në selinë qendrore të EUROPOL-it.

Gjithashtu, në ligj është përcaktuar që të gjitha shpenzimet që ka kjo marrëveshje dhe ratifikimi i saj, të mbulohen nga buxheti i Ministrisë së Brendshme dhe nga Drejtoria e Policisë së Shtetit.

Nisur nga sa më sipër, duke vlerësuar rëndësinë e këtij projektligji, i cili ka të bëjë drejtpërdrejt me rritjen e luftës ndaj krimit të organizuar, terrorizmit dhe formave të tjera të krimit ndërkombëtar, ftoj kolegët e mi ta miratojmë këtë marrëveshje.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Qefalia!

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Europian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi - Shqipëri, alokimet e vitit 2016”.

Fjalën e ka ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, zoti Bushati.

Ditmir Bushati – I nderuar zoti Kryetar,

Kolegë deputetë,

Para dy javësh ne miratuam në Kuvend një marrëveshje të ngjashme sa i përket programeve ndërkufitare me Kosovën dhe këtu kemi të bëjmë pak a shumë me të njëjtën marrëveshje sa i përket filozofisë, por palët në

rastin në fjalë janë Shqipëria dhe Mali i Zi. Bashkëpunimi rajonal, i cili mbështetet edhe nga programet ndërkufitare të Bashkimit Europian, merr një rëndësi të veçantë.

Së pari, sepse përmes këtyre programeve krijohet një mundësi për bashkëpunimin ekonomik, përtej mundësive që u lejojnë buxhetet respektive vendeve kufitare.

Së dyti, në rastin e bashkëpunimit me Malin e Zi, ka edhe një aspekt disi të veçantë, për shkak të faktit që të dyja vendet tona janë anëtare të NATO-s dhe aspirojnë të jenë anëtare të Bashkimit Europian, duke qenë edhe vende kandidatë.

Së treti, ky lloj bashkëpunimi është edhe konfirmimi konstant i politikës sonë të jashtme për një dinamizim të marrëdhënieve me fqinjët.

Në kontekstin kombëtar ky program merr një rëndësi të posaçme, për shkak se synon të korrigjojë deficienat në kuptimin e zhvillimit ekonomik të fjalës, që përgjithësisht ne i kemi në rajonin e Veriut dhe në rajonin e Verilindjes dhe kështu përmes aplikimit të këtyre projekteve synohet që të kemi një ndërlidhje më të mirë mes zonave ndërkufitare, siç ishte edhe rasti i Kosovës. Bëhet fjalë për alokimet e vitit 2016, që janë pjesë e ciklit 7-vjeçar buxhetor të Bashkimit Europian, me të njëjtën filozofi, me të njëjtën logjikë edhe në rastin në fjalë. Nga momenti i alokimeve të disbursimit dhe zbatimi i projekteve ka një afat 3-vjeçar që përcaktohet në përputhje me Rregulloren e Bashkimit Europian. Pra, bëhet fjalë për alokime me një vlerë rreth 1,7 milionë euro, duke përfshirë edhe bashkëfinancimet që japin qeveritë e dy vendeve tona, Shqipërisë dhe Malit të Zi. Jam duke folur për 2 milionë euro, kjo është arsyeja pse ky grant vjen për t’u miratuar në Kuvendin e Shqipërisë.

Ndërkohë, në total, bëhet fjalë për rreth 11 900 000 euro, pra rreth 12 milionë euro. Ky është një fond i hapur për aplikantë dhe funksionon mbi bazën e projekteve, ku aktorë shtetërorë apo jo shtetërorë duhet të sjellin projekte, të cilat miratohen për zonat që preken nga ky program, siç janë: qarku i Shkodrës, qarku i Lezhës dhe Bashkia e Tropojës, ndërsa për Malin e Zi janë një pjesë e rëndësishme e komunave dhe një pjesë e këtyre komunave, siç e thashë edhe në fjalën për pikën e kalimit doganor në Zogaj, janë të populluara nga shqiptarë.

Gjithashtu, e rëndësishme është se në këtë projekt të bashkëpunimit me Malin e Zi ne kemi një qasje të integruar, e cila për herë të parë është trupëzuar në mbledhjen e përbashkët të dy qeverive, që u zhvillua në qytetin e Shkodrës më 3 korrik të këtij viti, ku energjitë që burojnë kryesisht nga projektet kombëtare kombinohen me projektet e karakterit rajonal, apo projektet e karakterit ndërkufitar.

Pikërisht, alokimet e 2016-s, do të funksionojnë mbi bazën e disa projekteve, të cilat gjerësisht konsiderohen si projekte të suksesshme, siç është rikonstrukcioni i pikës së kalimit kufitar të Hanit të Hotit, që është një program i financuar nga bashkëpunimi ndërkufitar plus fondet IPA kombëtare, i cili përveçse do t'ia ndryshojë faqen pikës së kalimit doganor, do të shoqërohet me zgjerimin e rrugës dhe me ndërtimin e terminalit të ri doganor.

Me vendosjen e shenjave ose bovave të demarkacionit në Liqenin e Shkodrës shpresojmë që ky projekt dhe zbatimi i tij t'i shërbejë edhe paqimit mes fqinjëve, edhe si pikë referimi për raste të ngjashme, aq më tepër tani që flitet gjithnjë e më tepër për proceset e vështira të demarkacionit.

Pika e kalimit kufitar, që është ndërtuar në Grabon dhe komplet infrastruktura që lidh Malin e Zi me Shqipërinë, që kalon përgjatë lumit Cem, janë pjesë e bjeshkëve tona në Malësi të Madhe, por që pak përmenden edhe në retorikën tonë.

Të gjitha këto projekte ne synojmë t'i fuqizojmë përmes fokusit të qartë që kanë projektet e bashkëpunimit ndërkufitar, kryesisht në çështjet e turizmit, të ndërlidhjes infrastrukturore dhe të komunikimit.

Prandaj unë kërkoj vëmendjen dhe mbështetjen tuaj të nderuar deputetë, sepse është në interesin strategjik të Shqipërisë të jetë sa më aktive në këto procese, pasi vendi ynë ka një specifikë të tillë që në zonat ndërkufitare rrethohet po me shqiptarë.

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Bushati!

Për këtë projektligj janë regjistruar për të diskutuar deputetët: Gjylameti, Hoxha, Dhima, Shalsi, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, dhe Kushi.

Fjalën e ka zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – I nderuar Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Si deputetë kemi mbajtur qëndrime për çështje të ndryshme politike, si dhe kemi miratuar shumë nisma me impakt të drejtpërdrejtë te qytetarët. E tillë është edhe nisma e sotme, e cila ka të bëjë me përmirësimin e jetës së qytetarëve të Malit të Zi dhe Shqipërisë.

Përmes miratimit të kësaj marrëveshjeje ndërmjet Shqipërisë, Malit të Zi dhe Komisionit Europian, për të cilën jemi mbledhur dhe do ta miratojmë, do të përfitojnë rreth 740 mijë banorë.

Me këtë marrëveshje u hapim rrugë zhvillimi disa projekteve të rëndësishme, që synojnë të jenë katalizatorë të zhvillimit socioekonomik të zonave ndërkufitare, si edhe rritjes së bashkëpunimit në mes dy vendeve nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta.

Financimi do të sigurohet nëpërmjet instrumentit të paraanëtarësimit IPA 2 dhe është në total 1,7 milionë euro për të dyja vendet, ndërsa pjesa tjetër e financimit prej 300 mijë eurosh, do të sigurohet nga bashkëfinancimi i të dyja vendeve.

Shkodra, Lezha dhe Tropoja janë tri zonat që do të përfitojnë direkt nga kjo marrëveshje, ndërsa në Malin e Zi do të përfitojnë 12 zona.

Gjithashtu, miratimi i kësaj marrëveshjeje i hap rrugë zhvillimit të qëndrueshëm të rajonit duke nxitur turizmin, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Një rëndësi të veçantë në këtë projekt ka edhe mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimaterike, si dhe marrja e të gjitha masave të nevojshme për parandalimin dhe menaxhimin e rrugës.

Po nga ky financim dy vendet do të përfitojnë rritje të vendeve të punës, pasi përmes projekteve që priten të realizohen do të nxitet punësimi, si dhe do t'i jepet një nxitje e mëtejshme rritjes së lëvizjes gjeografike të punonjësve dhe përfshirjes sociale dhe kulturore përtej kufirit.

Programi do të krijojë mundësi përfituese në shkëmbimin e përvojave dhe njohurive për të dyja vendet tona. Përfitues do të jenë jo vetëm institucionet jobuxhetore, por edhe organizata jofitimprurëse.

Të nderuar kolegë deputetë, fqinjësia e mirë me Malin e Zi është shembull i shkëlqyer i

marrëdhënieve të mira, ndaj e shikoj tepër të domosdoshme nevojën për të thelluar bashkëpunimin dhe për ta konkretizuar atë në aspekte të shumta.

Është koha për ta parë hapësirën e përbashkët ku ne jetojmë si mundësi prosperiteti për qytetarët e dy anëve të kufirit dhe bashkëpunimit ndërkufitar. Kushdo që kalon në zonat ndërkufitare e kupton se marrëdhëniet njerëzore janë të shkëlqyera, ndaj është domosdoshmëri që edhe institucionet shtetërore të të dyja vendeve të jenë nxitëse të forta të shkëmbimit të ideve dhe eksperiencave. Bashkimi i forcave mes nesh për hapjen e pikave të reja kalimtare kufitare, si edhe për zbatimin e planeve të zhvillimit ndërkufitar do të vazhdojë me vënien në pah dhe shfrytëzimin e vlerave të mëdha ekonomike dhe turistike që bart e gjithë kjo zonë që bashkëndajmë.

Shqipëria dhe Mali i Zi kanë potenciale të jashtëzakonshme, të cilat, nëse do të kenë edhe një harmonizim të politikave të të dyja vendeve, do të jenë një katalizator i rëndësishëm për të çuar më tej zhvillimin dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve këtej dhe matanë kufirit. Ndaj do ta theksoja si të një rëndësie të veçantë promovimin e përbashkët të këtyre pasurive në të dyja vendet, si dhe krijimin e politikave të harmonizuara në mbrojtje të mjedisit dhe në zhvillimin racional të kapaciteteve turistike duke shfrytëzuar bukuritë tona natyrore me qëllim rritjen e kapaciteteve pritëse për më shumë turistë.

Është shumë e domosdoshme të shohim drejt perspektivës europiane, sepse të dyja vendet aspirojnë të jenë anëtare të barabarta të familjes së madhe europiane. Mali i Zi ka bërë një progres të jashtëzakonshëm në rrugëtimin e tij drejt BE-së, ashtu siç Shqipëria po ndërmerr reforma të shpejta dhe tepër të rëndësishme për të ndryshuar jo vetëm infrastrukturën, por mbi të gjitha mendësinë dhe ekonominë e qytetarëve tanë.

Dy vendet tona tani ecin si partnerë të besueshëm duke mbështetur pa rezerva njëri-tjetrin në proceset integruese. Mali i Zi ka se çfarë të mësojë nga Shqipëria në rrugëtimin e saj në NATO, sikundër vendi ynë nga Mali i Zi në procesin e tij të integritimit në BE, duke forcuar në këtë mënyrë stabilitetin e rajonit dhe

konsolidimin e perspektivës euroatlantike të popujve të tij.

Afërsia midis dy vendeve dhe miqësia midis dy popujve tanë duhet të kthehet në akseleratorë të rritjes së lëvizshmërisë së produkteve dhe rritjes së pranisë së investimeve. Një nga projektet strategjike ndërmjet dy vendeve tona është edhe ndërtimi i autostradës adriatiko-joniane, sikundër do të ishte me shumë vlerë edhe realizimi i gazsjellësit adriatiko-jonian, në mënyrë që Mali i Zi dhe Kroacia të përfitojnë drejtpërdrejt nga gazsjellësi Trans-Adriatik nga pikëpamja energjetike si dhe të fuqizohen në mënyrë të ndjeshme edhe kapacitetet rajonale.

Afërsia gjeografike dhe struktura e ngjashme ekonomike mund të kontribuojnë shumë për lidhshmërinë më të fuqishme të të dyja ekonomive tona dhe realizimin e aktiviteteve në mënyrë të papenguar kuadër të aktiviteteve të akorduara. Bizneset dhe njerëzit janë ata që i kanë ndërtuar urat e komunikimit midis tyre, ndaj institucionet shqiptare dhe ato malazeze duhet të kontribuojnë për t'i mbështetur në këtë frymë të re bashkëpunimi në rajonin tonë.

Kujtojmë se edhe midis dhomave respektive të tregtisë dhe të biznesit ka edhe një memorandum bashkëpunimi, ndërkohë që është për t'u përshëndetur edhe marrëveshja ndermet Agjencisë tonë për Zhvillimin e Investimeve dhe Agjencisë së Malit të Zi për Promovimin e Investimeve.

Kolegë, në këtë frymë bashkëpunimi, edhe marrëveshja e sotme është një gur më shumë në bashkëpunimin afatgjatë ndërmjet dy vendeve tona dhe popujve tanë.

Programi do t'u krijojë mundësi përfituesve të të dyja vendeve të shkëmbejnë përvojën dhe njohuritë. Ai do të mbështetet edhe në përmirësimin e politikave publike ndërmjet autoriteteve kontraktore, rajonale e lokale në zonat përkatëse.

Programi që parashikohet të financohet me këtë marrëveshje është pjesë e programit të bashkëpunimit të vendit tonë me Malin e Zi për periudhën 2014-2020, i cili parashikon një financim nga BE-ja prej 11, 9 milionë euro. Ky financim detajohet në marrëveshjet specifike, sikundër është edhe marrëveshja që është ratifikuar më parë për alokimet e viteve 2014-

2015, si edhe marrëveshjet e tjera që do të ratifikohen në vijim.

Inkurajimi i mëtejshëm i marrëdhënies midis shqiptarëve dhe malazezëve është një faktor stabiliteti, ndaj duhet të punojmë bashkërisht për ta çuar para këtë proces.

Liçeni i Shkodrës dhe pellgu i ujerave të lumit Buna nuk duhen parë si faktor ndarës, por si një pasuri e përbashkët që na bashkon, po ashtu edhe si faktor ndërgjegjësimi për potencialet tona të mëdha nëse jemi bashkë.

Ndaj, unë shpreh bindjen e plotë se vendet tona duhet ta vijojnë këtë angazhim të nisur edhe në kuadër të Procesit të Berlinit dhe nismave të tjera, që synojnë përmasimin e bashkëpunimit ndërmjet të gjitha vendeve të rajonit.

Të nderuar kolegë, për sa rendita më sipër, ju ftoj ta votojmë projektligjin.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi - Fjala për zonjën Gjebrea.

Elona Gjebrea - I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë dhe qytetarë,

Sot miratojmë marrëveshjen e financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Malit të Zi dhe Komisionit Europian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi - Shqipëri.

Kjo marrëveshje ka një rëndësi të veçantë, pasi kontribuon në zhvillimin afatgjatë ndërmjet zonave të përcaktuara, si pjesë e projektit, dhe forcon bashkëpunimin ndërmjet shteteve.

Në Shqipëri përfshihen tri rajone përfituese: Shkoda, Lezha dhe rrethi i Tropojës, kurse në Malin e Zi përfitojnë 11 bashki dhe rajone.

Zona e programit, ku do të zbatohen projektet, mbulon një territor prej 11,970 kilometrash katrorë me një popullsi që arrin rreth 900 mijë banorë.

Programi do të fokusohet në disa prioritetet tematike, si: mbrojtja e mjedisit, përshtatja dhe lehtësimi i ndryshimeve klimatike; parandalimi dhe menaxhimi i riskut, turizmi dhe trashëgimia kulturore dhe natyrore, lëvizja gjeografike e punonjësve, punësimi, si dhe përfshirja sociale e kulturore përtej kufirit.

Alokimet e vitit 2016 në këtë program financohen nga një grant i BE-së, nëpërmjet fondeve IPA II, me një vlerë prej 1 milion e 700 mijë eurosh për të dyja vendet.

Përfitues të këtij programi nuk do të jenë vetëm institucionet shtetërore buxhetore, por edhe organizata e shoqata të tjera jofitimprurëse, të cilat nuk ndikojnë në të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore.

Vlen të theksohet se kontributi që do të japë BE-ja për zbatimin e përbashkët të programit Shqipëri-Mali i Zi arrin vlerën 11 milionë e 900 mijë euro. Alokimet e mëtejshme do të jenë subjekt i nënshkrimit të marrëveshjeve të tjera financiare nëpërmjet vendit tonë, Malit të Zi dhe Komisionit Europian.

Shqipëria dhe Mali i Zi do të bashkëpunojnë ngushtë me delegacionin e Bashkimit Europian në Tiranë për koordinimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të programit.

Bashkimi Europian, që është edhe donatori më i madh për Shqipërinë, ka rikonfirmuar përkushtimin për të mbështetur Shqipërinë në zbatimin e reformave duke u përqendruar te qeverisja, drejtësia dhe shteti ligjor, ndërlidhja, konkurrenca, si dhe te zhvillimi socioekonomik.

Programi ka reflektuar rëndësinë që BE-ja u kushton çështjeve horizontale dhe ndersektoriale, çështje këto të reflektuara nëpërmjet zgjedhjes së prioritetëve të tilla, si: krijimi i partneriteteve ndërkufitare, autorësia vendore dhe mundësitë e barabarta, garantimi i mosdiskriminimit të minoriteteve, mbrojtja e mjedisit, të drejtat gjinore e të tjerë.

Projektet IPA do të vijnë në ndihmë të bashkëjetesës në mbarë rajonin dhe në ndihmë të bizneseve në vendet ndërkufitare. Këto projekte sollën zhvillime në disa bashki të vendit nëpërmjet programeve të mëparshme. Gjithashtu, këto projekte, përtej kësaj shume të madhe parash, shkojnë për përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Eksperiencia e deritanishme në menaxhimin e fondeve IPA në Shqipëri, sikurse edhe disa gjetje të vlerësimeve të kryera apo raporteve të prodhuara nga projektet e asistencës teknike, tregojnë se planifikimi, programimi dhe zbatimi i asistencës IPA përballen me shumë sfida dhe probleme, ndaj duhet të merren në konsideratë mësimet e nxjerra.

Gjatë periudhës 2014-2020, në kuadër të programeve IPA, janë dhënë 242 milionë euro për projektet në rajon dhe për projektet ndërkufitare. Për Shqipërinë kjo nënkupton një

total prej 33,2 milionë eurosh për projektet me Malin e Zi, Kosovën dhe Maqedoninë dhe 145 milionë euro për projektet me Italinë dhe Greqinë.

Pavarësisht progresit të strukturave shqiptare në programimin dhe zbatimin e fondeve IPA, duhet të bëhen më shumë përpjekje në fazat e programimit dhe të përgatitjes buxhetore, të zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit. Gjithsesi, përfitimet e efikasitetit të synuar ende duhen të materializohen.

Raportet nga projektet e ndryshme IPA kanë treguar se përfshirja e modalitetit të menaxhimit indirekt me vendin përfitues ka të dyja anët e medaljes, sepse ofron një përmirësim të pronësisë së programit ndërmjet përfituesve, por në shumicën e rasteve efikasiteti ka mangësi në krahasim me menaxhimin direkt të fondeve. Në këtë kuadër është e nevojshme që të përmirësohen kapacitetet e strukturave të dedikuara për këtë proces. Kuadri ligjor për themelimin dhe funksionimin e këtyre strukturave ekziston, por kërkohet më shumë zbatim dhe një koordinim më i mirë mes institucioneve.

Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme është e angazhuar dhe po punon me dinamizëm në këtë proces. Duhet të sigurohet lidhja mes asistencës së BE-së, strategjive sektoriale dhe planeve të veprimit. Qëllimi është që të orientohej asistencë në lidhje me planet strategjike shqiptare, të cilat nga ana tjetër duhet të adresojnë kërkesat e procesit të integritetit në BE.

Ne duhet të komunikojmë. Qeveria shqiptare dhe institucionet përfituese duhet të shkëmbejnë më shumë informacione për integritetin në BE, përfshirë programin IPA, me shoqëritë civile dhe me bashkitë, duke dhënë informacion shpjegues në të gjitha fushat dhe duke diskutuar edhe kostot dhe përfitimet e procesit, pra duhet një koordinim më i mirë. Europën e bëjnë njerëzit që jetojnë aty dhe u përket atyre.

Të nderuar kolegë dhe qytetarë, ky është një vit vendimtar për progresin e Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian. Vijimi i implementimit të reformës në drejtësi do të bëjë të mundur që edhe Shqipëria t'u bashkohet vendeve fqinje, që tashmë i kanë hapur negociatat për anëtarësimin në BE.

Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme ka luajtur një rol kyç dhe të rëndësishëm në këtë proces. Pritshmëria jonë bazohet tek të gjitha reformat e bëra, të përpjekjet maksimale gjatë kësaj periudhe, si dhe tek ato çfarë qytetarët tanë presin, ata që janë nxitës dhe mbështetës të reformave të ndërmarra nga ne.

Të nderuar kolegë, ju ftoj që ta miratojmë marrëveshjen e sotme.

Faleminderit!

(Drejtimitin e seancës e merr zonja Hysi.)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Fjalën e ka deputetja Antoneta Dhima.

Antoneta Dhima – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Një lajm i mirë për Shqipërinë dhe shqiptarët vjen nga Banka Botërore, e cila e vlerëson Shqipërinë si një vend të sigurt për investime. Pas publikimit të raportit *“Doing Business”*, Banka Botërore thekson se në vendin tonë vijon përmirësimi i klimës së të bërit biznes duke e renditur Shqipërinë me dy pozicione më lart në renditjen globale. Në të njëjtin raport, me përmirësime të ndjeshme, janë vlerësuar ndër të tjera pagesat e taksave, marrja e energjisë elektrike dhe regjistrimi i pronave.

Sipas raportit *“Doing business”* të vitit 2019 reformat e ndërmarra gjatë këtij viti kanë dhënë një impakt të drejtpërdrejtë duke përmirësuar ndjeshëm klimën e të bërit biznes. Në fakt, kemi ende shumë punë për të bërë në të gjithë sektorët e ekonomisë, por përmirësimi i klimës së të bërit biznes vazhdon pa u ndalur dhe po të njëjtin ritëm do të vijojë të ketë edhe gjatë periudhës në vazhdim.

Paketa fiskale e vitit 2019 do të garantojë lehtësim të mëtejshëm të barrës fiskale dhe përmirësim të procedurave. Nga zbatimi i paketës fiskale për vitin 2019 do të synohet të ulët norma e tatimit mbi dividendin nga 15% në 8%, nga ku do të përfitojnë rreth 20 mijë biznese ose mbi 50 mijë investitorë të kapitalit. Nga ulja e normës së tatimit mbi fitimin me dy të tretat do të përfitojnë 11 mijë biznese. Po kështu mbi 50 shoqëri të bashkëpunimit bujqësor do të përfitojnë nga incentivi i fermerëve të inkuorpuar. Nga ulja e taksave të ndryshuara, si ajo e ambalazheve, do të përfitojnë ulje në kosto

dhjetëra operatorë të kësaj fushe. Nga përjashtimet e parashikuara në tatimin mbi vlerën e shtuar do të lehtësohet veprimtaria e qindra operatorëve ekonomikë në industrinë fashione, në atë farmaceutike dhe të makinerive bujqësore.

Marrëveshja që po diskutojmë ka për qëllim të kontribuojë në zhvillimin socioekonomik të zonave ndërkufitare dhe të rrisë bashkëpunimin midis dy vendeve nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta. Programi, gjithashtu, mbështet shkëmbimin e eksperiencës dhe të njohurive nëpërmjet përfituesve, dhe ndikon ndjeshëm edhe në përmirësimin e politikave publike mes autoriteteve kombëtare rajonale dhe lokale në zonat e programit.

Marrëveshja është nënshkruar për palën shqiptare nga ministri për Europën dhe Punët e Jashtme në datën 29 dhjetor të vitit 2017. Alokimet e vitit 2016 për këtë program financohen nga një grant i BE-së nëpërmjet instrumentit IPA II, me një vlerë prej 1 milion e 700 mijë eurosh për të dyja vendet. Por, duke marrë parasysh edhe bashkëfinancimin kombëtar të të dyja shteteve me 300 mijë euro, buxheti i përgjithshëm i programit për vitin 2016 arrin vlerën 2 milionë eruro. Në total kontributi i Bashkimit European për zbatimin e përbashkët të programit Mali i Zi – Shqipëri, për periudhën 2014 – 2020, arrin vlerën prej 11 milionë e 900 mijë eurosh. Përfitues të këtij programi në Malin e Zi do të jenë rreth 12 zona, ndërsa në Shqipëri do të jenë Shkodra, Lezha dhe rrethi i Tropojës.

Programi në fjalë mbulon një territor prej 11 mijë e 970 metrash katrorë, me një popullsi rreth 749 mijë e 257 banorë. Projekti do të përzgjidhet sipas një procesi transparent aplikimi.

Programi do të fokusohet në tri prioritetet kryesore.

E para, nxitja e turizmit dhe e trashëgimisë kulturore e natyrore.

E dyta, mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe e lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut.

E treta, nxitja e punësimit përmes lëvizjes gjeografike të punonjësve dhe përfshirjen sociale e kulturore përtej kufirit.

Shqipëria është vend i bekuar për bukuritë natyrore dhe zona ku ky projekt do të zbatohet ka resurse dhe mundësi të mjaftueshme për

zhvillimin e turizmit dhe trashëgimia përcillet me krenari.

Edhe këtë vit vendi ynë mbeti një destinacion i lakmueshëm për turizmin bregdetar, i cili u ndërthur shumë mirë me aventurën dhe eksplorimin.

Viti 2018 mund të quhet viti i turizmit shqiptar, për faktin se numri i turistëve që kanë vizituar vendin tonë është rritur ndjeshëm krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo edhe për faktin se institucionet përgjegjëse i kanë parë problemet në sy dhe mbi të gjitha kanë bërë të mundur zgjidhjen dhe adresimin e tyre.

Risi për zhvillimin e turizmit për këtë vit ishte edhe projekti “*Smile Albania*”, i cili angazhoi rreth 1000 të rinj dhe të reja për të promovuar Shqipërinë turistike dhe për t’i ofruar çdo turisti që hyn në Shqipëri arsyet për të qëndruar, për të qenë të lumtur dhe për t’i dhënë mundësinë që ata të rikthehen përsëri.

Projekti i qeverisë shqiptare synon të koordinojë ndërhyrjen zhvillimore në hapësirën rurale, nëpërmjet një qasjeje ndërsektoriale: bujqësi, turizëm, kulturë dhe ekonomi.

Ky projekt do t’i kthejë fshatrat e përzgjedhura në destinacione të mirëfillta turistike, duke i dhënë kështu një hov zhvillimit ekonomik dhe social, që deri më sot, për shumicën dërrmuese, dukej e pamundur.

Qeveria shqiptare e ka parë agroturizmin si një mekanizëm të tërheqjes drejt fshatit, falë bukurive natyrore, trashëgimisë kulturore dhe historisë së zonave, për daljen nga varfëria dhe kthimin e emigrantëve, të cilët i investojnë kursimet në zonat e tyre.

Një shoqëri nuk mund të ekzistojë pa identitet. Dhe cila më mirë se trashëgimia kulturore mund ta përcjellë identitetin e vërtetë të një kombi?

Shqipëria ka fatin e mirë që është e pasur me vlera kulturore të çmuara, që me shumë fanatizëm janë ruajtur brez pas brezi.

Një tjetër aks prioritar në këtë program do t’i dedikohet asistencës teknike prej 1 milionë e 190 mijë eurosh për të gjithë periudhën e zbatimit, 2014-2020, për të dyja vendet, që përbën rreth 10% të buxhetit të përgjithshëm të programit. Kjo asistencë do të përdoret kryesisht për zbatimin efektiv, transparent dhe në kohë të

programit të bashkëpunimit ndërkufitar nga strukturat kombëtare dhe ato teknike.

Programi është në përputhje të plotë me strategjinë e BE-së për rajonin e Adriatikut dhe Jonit dhe në të dyja vendet mund të zbatohen projekte strategjike të përbashkëta, në kuadër të strategjisë makrorajonale në të cilën bëjnë pjesë.

Si deputete e qarkut të Fierit, falënderoj Kryeministrin Rama për lajmin e mirë që u dha qytetarëve të Fierit dhe të Vlorës, për mbylljen e procedurave dhe fillimin e punimeve për të dyja veprat infrastrukturore: bajpasin e Fierit dhe bajpasin e Vlorës! Përfundoi kështu makthi për të gjithë shoferët, që lëvizin drejt Jugut përmes qyteteve të Fierit dhe Vlorës.

Përfundimi i këtyre akteve rrugore deri në qershor të vitit 2019, si dhe hapja e trasesë, do të sjellë rritje të numrit të pushuesve dhe turistëve që dëshirojnë të vizitojnë dhe të pushojnë në Bregdetin e Jonit dhe të Adriatikut.

Gjithashtu, dua të falënderoj ministrin e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për akordimin e fondit për kryerjen e pagesës së dëmshpërblimit për 71 familje, banesat e të cilave janë dëmtuar 100% nga lëkundjet e tokës në njësinë administrative Zharrëz! Njëkohësisht, i inkurajoj dy ministrat të vijojnë procedurat e vlerësimit për likuidimin e dëmeve të shtëpive të tjera, të cilat janë dëmtuar pjesërisht, si dhe kërkoj angazhimin maksimal për zbatimin e ligjit nr. 8/2017, datë 2.2.2017, "Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit".

Në kushtet kur projektligji që po diskutojmë sot është në përputhje me Kushtetutën, me marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe ka në fokus interesin e qytetarëve, të nderuara kolege dhe kolegë deputetë, ju ftoj ta miratojmë atë!

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Dhima!

Këtu përfundojnë edhe diskutimet e kolegëve të regjistruar.

Kalojmë me shprehjen në emër të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste do të flasë deputetja Evis Kushi.

Evis Kushi – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Projektligji që do të votojmë sot ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komsionit European, për programin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, midis Malit të Zi dhe Shqipërisë.

Financimi do të sigurohet nëpërmjet një granti 1,17 milionë euro të Bashkimit European, për të dyja vendet. Përveç këtij granti, do të shtohet edhe shuma 300 mijë euro, e cila do të sigurohet nga bashkëfinancimi i të dyja vendeve. Pra, buxheti i përgjithshëm për alokimet e vitit 2016, për këtë program do të arrijë vlerën 2 milionë euro për të dyja vendet.

Pritshmëritë janë që vendi ynë të përfitojë një grant prej 850 mijë eurosh, përfitues të të cilit do të jenë jo vetëm institucionet buxhetore, por edhe organizatat dhe shoqatat jofitimprurëse.

Rreth 85% e financimit është granti i Bashkimit European dhe rreth 15% është bashkëfinancim kombëtar.

Shuma prej 2 milionë eurosh do të përdoret për financimin e projekteve në përputhje me fushat prioritare të programit, që do të përzgjidhen pas një procesi transparent aplikimi.

Financimi në total detajohet në marrëveshjet specifike, siç është marrëveshja që po ratifikojmë sot me këtë projektligj, marrëveshja e ratifikuar më parë për alokimet e vitit 2015 dhe 2014, si dhe marrëveshjet e tjera që do të ratifikohen në vitet e ardhshme.

Përfitues të këtij programi në vendin tonë janë zonat e Shkodrës, Lezhës dhe Tropojës, ndërsa në Malin e Zi janë rreth 12 zona.

Programi ka si qëllim të kontribuojë në zhvillimin social dhe ekonomik të zonave ndërkufitare, si dhe të rrisë bashkëpunimin mes dy vendeve, nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta. Programi do t'u krijojë mundësi përfituesve të të dyja vendeve të shkëmbejnë përvojat dhe njohuritë midis tyre.

Programi do të mbështetet edhe në përmirësimin e politikave publike, midis autoriteteve kontraktore, rajonale dhe lokale në zonat përkatëse.

Programi mbulon një territor prej afro 12 mijë kilometrash katrorë, me një popullsi mbi 749 mijë banorësh dhe synon zhvillim të qëndrueshëm, duke u dhënë prioritet tri fushave të rëndësishme.

Së pari, synon nxitjen e turizmit dhe të trashëgimisë kulturore natyrore.

Së dyti, mbrojtjen e mjedisit, nxitjen e përshtatjes dhe lehtësimin ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe parandalimin dhe menaxhimin e rrezikut.

Së treti, nxitjen e punësimit, lëvizjen gjeografike të punonjësve dhe përfshirjen sociale e kulturorë përtej kufirit.

Duke qenë se shuma e financimit do të detajohet sipas projekteve, nga njëra anë, inkurajoj institucionet dhe organizatat jofitimprurëse të aplikojnë me projekte serioze, në përputhje me prioritetet e programit dhe, nga ana tjetër, është e nevojshme që strukturat ekzekutive të rrisin mbështetjen ndaj hartuesve dhe propozuesve të projekteve, për të mundësuar përthithjen e projekteve më cilësore, zbatimimi i të cilave do të çojë në realizimin me sukses të programit.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Kushi!

Këtu përfundon edhe diskutimi në parim për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Europian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi-Shqipëri, alokimet e vitit 2016”.

Të nderuar kolegë, nuk ka më diskutime.

Bëjmë pak pushim dhe më pas kalojmë në votim.

Ju lutem, të thirren të gjithë kolegët për të hyrë në sallë!

(Rifillon seanca)

(Drejtimin e seancës e merr zoti Ruçi.)

Gramoz Ruçi - Të futet media brenda.

Vazhdojmë me seancën.

Fillojmë me votimet.

Hapet votimi për prezencën.

Të hiqet karta e deputetit Rahja

Mbyllet votimi.

74 deputetë janë prezentë.

Kalojmë në votimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj, Republika e

Shqipërisë – Skje, Mali i Zi, për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në liqenin e Shkodrës”.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet në parim.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen me kartonë, sipas variantit të paraqitur nga propozuesi.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet në tërësi.

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Bashkimit Europian për bashkëpunimin e zbatimit të ligjit për vendosjen e oficerit ndërlidhës të EUROPOL-it”.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kalojmë në votimin nen për nen me kartonë, sipas variantit të paraqitur nga propozuesi.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet në tërësi.

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Europian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi - Shqipëri, alokimet e vitit 2016”.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nën për nën me kartonë, sipas variantit të paraqitur nga propozuesi.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kalojmë te projektvendimi “Për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”. Mbështetur në nenin 14, pika 1, germa “a”, të Kodit Zgjedhor, Kuvendit i lind detyrimi ligjor për të bërë plotësimin e dy vendeve vakante në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nga partia që ka marrë numrin më të madh të vendeve nga partitë e shumicës parlamentare.

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste nga 4 kandidatura të propozuara, konkretisht: Rezarta Bitri, Arens Çela, Elira Kokona, Bledar Skënderi, ka përzgjedhur me anë të kryetarit 2 kandidatura: zonjën Rezarta Bitri dhe zotin Bledar Skënderi.

Ju njoftoj se grupet e tjera parlamentare, edhe pas përfundimit të të gjitha afateve të arsyeshme, nuk i kanë ushtruar të drejtat e parashikuara në nenin 14 të Kodit Zgjedhor. Komisioni i Ligjeve, me cilësinë e komisionit përgjegjës ka marrë në shqyrtim përmbushjen e kriterëve ligjorë dhe meritën e dy kandidatëve të përzgjedhur dhe ka dalë në konkluzionin se të dyja kandidaturat i plotësojnë kriteret e parashikuara në Kodin Zgjedhor.

Para se të kalojmë në votim, zoti kryetar i grupit të maxhorancës, keni ndonjë gjë?

Taulant Balla - Zoti Kryetar,

Kolege dhe kolegë deputetë,

Kërkova fjalën për të sqaruar sadopak kryetarin e opozitës, Lulzim Bashën, i cili në një komunikim me medien u shpreh se nga dy kandidaturat që votojmë, njëra i përket Partisë Demokratike.

Lulzim, të takojnë 2 kandidatura, jo 1. Pra, nga 4 vakanca të krijuara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve 2 në mënyrë të barabartë i takojnë maxhorancës dhe 2 i takojnë opozitës, jo 1. Përfitojmë nga rasti që t'i rikërkojmë edhe sot Partisë Demokratike, opozitës, të sjellë dy kandidaturat, jo një.

Lulzim, nuk ta kanë shpjeguar mirë të tutë, nga 4, ke gjysmat.

Për sa i përket partisë që ka numrin më të madh të mandateve në shumicë, jemi vetëm ne, Partia Socialiste e Shqipërisë, që do të thotë se të dyja vendet që i takonin shumicës parlamentare të legjislaturës së vitit 2009 – 2013, tashmë i takojnë shumicës parlamentare të legjislaturës 2017 – 2021.

Dy ish-anëtarët e KQZ-së, Vera Shtjefni, dhe anëtari tjetër, janë dy anëtarë, të cilët kanë qenë propozime të Partisë Demokratike. Automatikisht, dy propozimet e reja i takojnë partisë që sot ka shumicën parlamentare: Partisë Socialiste.

Thënë këto, edhe pas dëgjësës së zhvilluar në komision, Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste i ndoqi germë për germë parashikimet e Kodit Zgjedhor lidhur me prezantimin e katër kandidaturave. Nga këto kandidatura u përzgjedhën dy, dhe sot Kuvendi i Shqipërisë bën votimin për dy kandidaturat, që gjej rastin t'i inkurajoj që të bëjnë një punë në respekt të plotë të ligjit, të mbarëvajtjes së procesit zgjedhor të zgjedhjeve vendore të qershorit 2019, zgjedhje për të cilat tashmë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të fillojë përgatitjen, për të pasur zgjedhje tërësisht në zbatim të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it, por mbi të gjitha në zbatim të ligjit.

Për këtë qëllim, do t'u kërkoja të gjithë deputetëve që të mbështesin dy kandidaturat: Rezarta Bitri, një juriste e shkëlqyer në profesion, apartiake, sepse është ligji që na e imponon, që në këto pozicione kaq të rëndësishme të mos bëjmë propozime politike. Ligji thotë se nuk duhet të ketë asnjë lloj përkatësie politike. Po kështu edhe kandidati tjetër, Bledar Skënderi, i cili ushtroi në mënyrë efikase dhe krejtësisht mirë mandatin plotësues nga viti 2016 deri më tani.

Faleminderit të gjithëve!

Gramoz Ruçi – Vazhdojmë me procedurën e votimit. Do të bëhen dy votime, secili më vete.

Votimi është me elektronikë, i fshehtë. Konkurojnë dy kandidatë për dy vende. Kërkohej shumicë e thjeshtë votash.

Fillojmë me kandidatët një e nga një.

Hapet votimi për zonjën Rezarta Bitri.

Mbyllet votimi.

74 vota pro. Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet!

Zonja Bitri bëhet anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Hapet votimi për zotin Bledar Skënderi.

Mbyllet votimi.

74 vota pro. Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet edhe zoti Bledar Skënderi.

A janë kandidatët prezentë? Janë. Atëherë, në mbështetje të nenit 13, pika 4, të Kodit Zgjedhor, përpara fillimit të detyrës, anëtar i zgjedhur për në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kryen betimin para Kuvendit, në një ceremoni publike.

Ftoj të dy kandidatët që të futen në sallë.

Zonja Bitri,

Zoti Skënderi,

Urime! Jeni të ftuar të bëni betimin, sipas Kushtetutës. Unë do të lexoj tekstin e betimit dhe në fund ju do të betoheni para Kuvendit të Shqipërisë:

“Betohem në nderin tim, se do të angazhohem me të gjitha forcat e mia për realizimin e zgjedhjeve të drejta, të lira dhe demokratike në Republikën e Shqipërisë, se do të siguroj dhe do të mbroj integritetin dhe fshehtësinë e votës, do të ruaj paanësinë në kryerjen e detyrës si anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, do të tregoj profesionalizëm në kryerjen e saj.”

Zonja Bitri.

Rezarta Bitri – Betohem!

Gramoz Ruçi - Zoti Skënderi.

Bledar Skënderi – Betohem!

Gramoz Ruçi - Urime dhe suksese!

Mund të largoheni.

Vazhdojmë me miratimin e kalendarit trejavor të punimeve të Kuvendit, për periudhën 5 nëntor deri më 23 nëntor 2018.

Ju njoftoj se ditën e martë u mbledh Konferenca e Kryetarëve, që diskutoi në lidhje me draftkalendarin trejavor për periudhën në vijim. Opozita nuk mori pjesë në Konferencë, ndaj në mbështetje të nenit 27, pika 4, të Rregullores, e hedhim në votim.

Kush është dakord me kalendarin? Votimi me karton. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kalendarin trejavor të punimeve të Kuvendit do ta gjeni të publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit, si zakonisht.

Vazhdojmë me miratimin e projekt-kalendarit të veçantë të shqyrtimit të projektbuxhetit të shtetit për vitin 2019 dhe projektligjeve financiare që e shoqërojnë atë. Sikurse e thashë në fillim të seancës, ditën e martë u zhvillua mbledhja e Konferencës së Kryetarëve, ku u prezantua projektbuxheti. Opozita nuk mori pjesë. Për pasojë, në mbështetje të nenit 79, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, Kryetari i Kuvendit ia paraqet projektkalendarin për votim seancës plenare. Projektkalendarin është bërë nga kryesia e komisionit përgjegjës, që në rastin konkret është Komisioni i Ekonomisë dhe Financave. E keni të gjithë përpara, mbi tavolinat tuaja. Procedura e votimit është e hapur. Kërkohej shumicë e thjeshtë votash.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

74 vota pro. Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet kalendarin i shqyrtimit të projektbuxhetit për vitin 2019 dhe projektligjet financiare që e shoqërojnë atë.

Janë dy projektligje të bartura, siç thashë edhe në fillim të seancës, projektligji për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe projektligji për ndryshimet në Kodin Rrugor.

Duke pasur parasysh se nuk është kuorumi, pasi kërkohej shumicë e cilësuar, projektligjet nuk kalojnë për votim.

Urdhëroni, zoti Ndreu!

Pjerin Ndreu – Si propozues i ndryshimeve në Kodin Rrugor, jam i detyruar të kërkoj prezencën e opozitës që të ushtrojë përgjegjësitë e veta për të ndërhyrë në këtë kod e të zgjidhë një problem, i cili është një ngërç i jashtëzakonshëm dhe po krijon pengesa të jashtëzakonshme në përditshmëri.

Retorika nacionaliste dhe dashuria e madhe që shprehin deputetët e opozitës për vëllezërit tanë kosovarë duhet të tregohet këtu, duke miratuar ndryshimet, sepse janë pikërisht kosovarët të dëmtuarit e parë për shkak të fluksit tejet të madh të ardhjes së tyre dhe frekuentimit në fundjavë ose edhe gjatë javës në zona të

ndryshme turistike të Shqipërisë. Ka një problem të pazgjidhshëm dhe për reciprocitet duhet thënë se, ndërsa në Kosovë ne e marrim patentën me gjobë, në Shqipëri ata nuk e marrin. Nëse e duan Kosovën kaq shumë, të vijnë këtu dhe ta votojnë; nëse i duan emigrantët tanë, që janë kategoria numër dy e goditur me këtë bllokim, duhet të vijnë dhe ta votojnë. Kjo është e rëndësishme edhe për turistët e huaj. Të tria këto kategori, nëse kryejnë një shkelje, nuk kanë absolutisht asnjë mundësi të marrin patentat dhe të ikin nga janë nisur, kundrejt një gjobe, por u duhet minimalisht një kalvar prej tre muajsh për të marrë patentën.

Është e pafalshme për opozitën që të mos vijë për të votuar zhbllokimin e një ngërçi të tillë.

Prandaj i bëj thirrje të vijë e ta zgjidhim këtë problem, të cilin unë e quaj “madhor” dhe duhet ndërhyrë njëherë e mirë e sa më shpejt të jetë e mundur.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Këtu mbyllet seanca e ditës së sotme.

Seanca tjetër do të njoftohet me mjete elektronike.

(Seanca u mbyll në orën 12:30.)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

Sekretari për Procedurat dhe Votimin

Alket Hyseni

**Drejtori i Shërbimit të Botimeve
Parlamentare
Krenar Hajdëri**